VENDIM
Nr. 125, datë 2.3.2022

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 420, DATË 8.6.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E CEREMONIALIT SHTETËROR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17, të ligjit nr. 23/2015, "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 420, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Në kapitullin VII, titulli i pikës 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Pajisja me targa CD, TR dhe HCC (të gjelbra)".

2. Pika 5.8, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"5.8 Konsujt e nderit, të emëruar në Republikën e Shqipërisë, kanë të drejtë të përdorin për qëllime pune, në funksion të pozicionit të tyre, jo më shumë se një automjet personal me targa, me inicialet dalluese "HCC", automjet i cili përjashtohet nga detyrimet doganore dhe TVSH-ja, të zbatuara në shitblerjen e automjeteve në Republikën e Shqipërisë.".

3. Në pikën 5.19, fjalët "... ose HCC e zakonshme (në rastin e konsujve të nderit) ..." zëvendësohen me "... ose HCC...".

4. Në pikën 5.24, në paragrafin e dytë, fjalët "... shenjën dalluese HCC..." zëvendësohen me "... targën HCC...".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama